



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 25.
Prishtinë, më 16.12.2011 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, , Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik dhe Etem Arifi.

Munguan: Elmi Reçica, Glauk Konjufca dhe Rasim Demiri.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues EUSR Visar Bivolaku, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-79 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.**

***Kryesuesi** - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

***Krzesuesi**- konstatoi se mbledhja është caktuar vetëm me një pikë të rendit i ditës dhe se e njëjta u miratua pa vërejtje.*

- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-79 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.**

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim Projektligjin nr. 04/L-79 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012 dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport me rekomandime, të cilat do t'i dërgohen Komisionit Funkcional.

Në diskutimin e tij tha se Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës është dokumenti më i rëndësishëm për vitin 2012, nuk ka mundësi të ndryshohet situata faktike, andaj ne duhet të procedojmë miratimin e tij në Kuvend

Petar Miletic – kur bëhet fjalë për buxhetin për vitin 2012, është mjaft restriktiv dhe se është e çart se gjendemi para një periudhe ku duhet të jemi sa më pragmatikë kur është fjala për kursime buxhetore.

Bazuar të fakte të njohura, ai shprehu qëndrimin e tij se përkrah Projektligjin e lartpërmendur.

Myfera Sinik- me theks të veçantë tha se lidhur me ndërtimin e shtëpisë së Kulturës për Turq, grupi Parlamentar 6+ ka paraqit amendamentet në komisionin funksional për Buxhet dhe Financa, dhe se e njejta nuk ka kaluar në këtë komision.

Me theks të veçantë tha se Komuna e Mitrovicës ka ndarë vendin për ndërtimin e shtëpisë së Kulturës për komunitetin turk. Grupi parlamentar 6+ ka kërkuar nga MEF dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa që të ndahet shuma prej 150,000 euro, për ndërtimin e shtëpisë së Kulturës në Mitrovicë për komunitetin Turk. Andaj kërkoi që ky amendamenti të përkrahet nga ky komision.

Petar Miletic- shprehu qëndrimin e tij se komisioni janë gjithnjë është solidar sa i përket zgjidhjes së çështjeve të komuniteteve por tani nuk kemi kohë se gjendemi në periudhën ku do të miratohet buxheti për Kuvend.

Ai konsideron se propozimi i grupit Parlamentar 6+ mund të gjej zgjidhje në një formë tjetër ku do ta ketë edhe përkrahjen nga komisioni janë.

Etem Arifi- plotësisht mbështet propozimin e znj Myfera duke shtuar se është projekt i cili do të shfrytëzohet nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Mitrovicë. Ai veçoi se asnjë projekt për komunitetin ashkali nuk është paraparë me projektbuxhetin e vitit 2012.

Ai konstatoi se nuk voton miratimin e buxhetit as në komision e as në Kuvend.

Albert Kinolli- në fjalën e tij tha se grupi Parlamentar ka mbajtur takim me Ministrin e MEF-it, dhe se nuk është respektuar në përgjithësi marrëveshja jonë.

Të gjithë jemi në dijeni se Investimet kapitale në cilat ministri janë ndarë në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Dhe shtoi se asnjë projekt kapital nuk është marrë parasysh sa i përket komunës së Prizrenit ku janë të fokusuar komuniteti romë, me mbi 5,500 pjesëtar.

Si grup Parlamentar 6+ kemi bërë kërkesë në komisionin për Buxhet dhe Financa për realizimin e 150.000 euro në ndërtimin e shtëpisë së Kulturës në Mitrovicë për komunitetin turk ku do të përfitonin edhe komunitetet tjera të cilët jetojnë në atë komunë.

Ai pajtohet me propozimin e znj. Myfera dhe z Etem, se grupi Parlamentar 6+ nuk do të përkrah miratimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012 në Kuvend.

Lumnije Morina- shprehu keqardhje për mos realizimin e projektit të propozuar nga grupi Parlamentar 6+ i cili nuk ka kaluar në komisionin për Buxhet dhe Financa . Ajo shtoi se shumica e projekteve kapitale nuk dedikohen vetëm për një komunitet.

Andaj ftoi kolegët që të tejkalohet kjo situatë dhe të votohet projektbuxhetin për vitin kalendarik 2012 dhe se bashkërisht do të angazhohemi në rishikim të buxhetit për realizimin e projektit tuaj.

Myfera Sinik- në emër të grupit parlamentar ajo shprehu qëndrimin se lidhur me këtë projektligj, grupi parlamentar 6+, në Kuvend nuk do të votoj miratimin e buxhetit për vitin 2012.

Komisioni ka konstatuar se propozim amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional në Projektligjin nr. 04/L-79 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, miratohen me shumicë të votave dhe tri kundër, dhe nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-79 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012 dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

]

Mbledhja përfundoi në orën 11:50

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic